



Espresso

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ROSKOVEC  
KRYETARI

Nr. 173 Prot

Roskovec, më 13.07.2025

**SHPLLJE PËR POZICIONIN  
KONSULENT PËR TRAJNIME**

**Në kuadër të projektit “Fuqizimi i komunitetit përmes shtimit të shërbimeve sociale në Qendrën Social-Komunitare, Bashkia Roskovec”, financuar nga UNDP-ja, programi “Leave no One Behind” (LNB2).**

**Bashkia Roskovec hap thirrjen për shprehje interesi për pozicionin :**

1. 1 (një) Konsulent për trajnime në fushën e shërbimeve sociale në territorin e Bashkisë Roskovec

**1. Përshkrim i shkurtër i projektit**

Në kuadër të projektit “Fuqizimi i komunitetit përmes shtimit të shërbimeve sociale në Qendrën Social-Komunitare, Bashkia Roskovec”, financuar nga UNDP-ja, programi “Leave no One Behind” (LNB2). Ky projekt ka si qëllim të shtojë shërbimet parashoqërore në qendrën Social Komunitare ku përfshihen kryesisht informimi dhe këshillimi, mbështetje psiko-sociale si dhe shërbime të tjera me bazë komunitare që synojnë përmirësimin e situatës së individit dhe familjes duke orientuar sa më shumë zgjidhje për nevojat përkatëse për shërbime sociale.

**Objektivi nr.1 :** Zgjerimi i shërbimeve dhe kategorive përfituese në Qendrën Social – Komunitare.

**Objektivi nr.2 :** Forcimi i kapaciteteve të stafit të shërbimeve sociale dhe stafit të Qendrës Social Komunitare.

**Objektivi nr.3 :** Ndërgjegjësimi dhe fuqizimi i anëtareve të komunitetit të Bashkisë Roskovec mbi shërbimet që ofrohen në Qendrën Social Komunitare.

Në kuadër të këtij projekti dhe përmbushjes së objektivave të tij do të zhvillohen 4 (katër) trajnime për rritjen e kapaciteteve të sektorëve dhe drejtorive që kanë në focus referimin dhe ofrimin e shërbimeve sociale dhe jo vetëm për të gjitha kategoritë në nevojë, përfshirë edhe funksionimin e Njesisë së Referimit dhe Vlerësimit të Nevojave NJVNR.

## **2.Kualifikime të ndryshme:**

- Diplomë universitare e ndërthurur me trajnime të specializuara në fushën e shkencave sociale;
- Njohuri shumë të mira rreth situatës së grupeve vulnerabël dhe në nevojë;
- Njohuri shumë të mira të Strategjisë Kombëtare për Mbrojtjen Sociale 2024-2030;
- Njohuri shumë të mira të paketës ligjore të shërbimeve shoqërore;
- Më tepër se 2 vite eksperiencë profesionale si ekspert dhe praktikë në sistemin e mbrojtjes sociale, shërbimeve sociale;
- Trajnime dhe eksperiencia të mëparshme në vlerësimin e nevojave të komunitetit në nivel lokal dhe kombëtar;
- Përvojë me koordinimin e veprimeve për realizimin e raporteve dhe analizave në fushën e mbrojtjes sociale.
- Aftësi të mira në përdorimin e paketës MS Office

## **3-Funksionet kryesore dhe detyrat specifike**

- Organizim I trajnimeve për rritjen e kapaciteteve të stafit për vlerësimin e nevojave dhe ofrimin e shërbimeve përfshirë dhe funksionimin e Njesisë së Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit të rasteve.
- Mentorimin e stafit të trajnuar dhe përmirësimi I cilësisë së shërbimeve.
- Përgatitja e materialeve trajnuese
- Të jetë kreativ.
- Të jetë i komunikueshëm dhe bashkëpunues.

- **Kohëzgjatja** : 3 Shkurt 2025 - 21 Mars 2025

#### **4- Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit**

Kandidati duhet të dërgoje me E-mail në adresën : [info@bashkiaroskovec.gov.al](mailto:info@bashkiaroskovec.gov.al)

Me postë ose dorazi në Bashkinë Roskovec dokumentet e dosjes së tij personale si më poshtë :

- 1-Kërkese për Shprehje interesi,
- 2- Curriculum Vitae (CV)
- 3- Diplomë në nivelin master në shkenca sociale (e noterizuar)
- 4- Fotokopje Karte ID
- 5- Dëshmi Penaliteti
- 6- Certifikata/eksperienca të mëparshme

Afati i dorëzimit të dokumentacionit nga aplikantët është deri në datën **28 .01.2025**

**KRYETAR**  
**Majlinda Buri**

